



Agjencia e mbikëqyrjes së sigurimeve  
Republika e Maqedonisë së Veriut

**K O N K U R S**

**për çmimin vjetor për studiuesit e rinj për punim më të mirë në fushën e menaxhimit të rrezikut dhe të sigurimeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitin 2020**

Me qëllim për të stimuluar zhvillimin e mendimit shkencor dhe përgatitjen e punimeve studimore në fushën e menaxhimit të rrezikut dhe të sigurimeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut, si dhe afirmimin e profesionistëve të rinj, Agjencia e Mbikëqyrjes të Sigurimeve do të ndajë çmimin vjetor të vitit 2020 për punim studimor në fushën e menaxhimit të rrezikut dhe të sigurimeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Çmimi vjetor i Agjencisë të Mbikëqyrjes së Sigurimeve është në vlerë prej 80,000.00 denarësh.

Në punimin studimor është i domosdoshëm shqyrtimi i ekonomisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut me temën adukuate. Punimi studimor nuk duhet të tejkalojë 15.000 fjalë (pa abstraktin, bibliografinë dhe anekset) si dhe është rekomanduese që të ketë strukturë standarte të punimit studimor, e cila i përmban pjesët si më poshtë:

- Abstraktin;
- Shqyrtimin e literaturës së konsultuar moderne, të huaj dhe vendase, shkencore dhe eksperte nga fusha e cila hulumtohet;
- Përshkrimin e metodologjisë së kërkimit shkencor të përdorur në punim;
- Analiza;
- Perceptimet përmbyllëse;
- Bibliografia.

Të drejtë për të marrë pjesë në konkurs kanë shtetasit e Republikës së Maqedonisë së Veriut deri në moshë tridhjetë e gjashtë vjeçare. Pjesëmarrësit të cilët kanë fituar titullin doktor shkencash deri në ditën e parashtrimit të punimit nuk kanë të drtejtë të marrin pjesë në konkurs.

Të punësuarit dhe anëtarët e Këshillit të Ekspertëve të Agjencisë të Mbikëqyrjes së Sigurimeve nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në konkurs.

Punimet studimore dorëzohen në gjuhën maqedonase, shqipe ose në gjuhën angleze.

Një autor mund të paraqesë vetëm një studim të pavarur kërkimor. Punimi studimor i punuar si bashkëautor nuk është i pranueshëm.

Në konkurs autorët mund të konkurojnë edhe me punime studimore të botuara gjatë vitit 2020. Në momentin e paraqitjes së punimeve studimore, autori duhet të specifikojë se kur dhe ku është botuar punimi studimor.

Konkursi do të konsiderohet i suksesshëm nëse aplikojnë së paku tre(3) punime studimore që i përmbushin kushtet e përmendura më lart.

Punimi studimor dorëzohet në Agjencinë e Mbikëqyrjes së Sigurimeve nëpërmjet postës elektronike, në adresën: [konkurs@aso.mk](mailto:konkurs@aso.mk) me shënim: "Për çmimin vjetor të Agjencisë të Mbikëqyrjes së Sigurimeve për vitin 2020".

Përveç punimit studimor, autori duhet të paraqesë të dhëna biografike. Punimet studimore të dorëzuara do të trajtohen si materiale konfidenciale.

Përzgjedhja e punimit më të mirë studimor bëhet nga Komisioni i përbërë nga pesë anëtarë, tre prej të cilëve janë anëtarë të jashtëm. Kryetarin dhe anëtarët e Komisionit i cakton Këshilli i ekspertëve të Agjencisë të Mbikëqyrjes së sigurimeve me vendim i cili do të shpallet në faqen e internetit të Agjencisë të Mbikëqyrjes së Sigurimeve.

**Afati i fundit për dorëzimin e studimeve kërkimore është me datën 30.09.2020.**

Çmimi vjetor i Agjencisë të Mbikëqyrjes së Sigurimeve do të jepet me datën 01.11.2020, me rastin e ditës së themelimit të Agjencisë të Mbikëqyrjes së Sigurimeve.